



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. - 1-1108

Br.

Data

Datum

31.07.2018

OBILIO-OBILIĆ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Në bazë të nenit 12.1, nenit 14 pika 1, neni 17 shkronja (c) neni 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40 të datës 4 qershor 2008, nenit 72, pika 1.8 e Statutit të Komunës së Obiliqit, nr.I-34 i dt.25.04.2016, dhe nenit 39 të Rregullorës të punës së kuvendit, dhe propozimit (DUPK) të Kryetarit të Komunës, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.07.2018, mori këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PËR SHPRONËSIM TË PALUAJTSHMËRIVE TË CILAT DO TË PREKEN ME RASTIN E NDËRTIMIT TË SHESHIT TË QYTETIT TË OBILIQIT

- I. Aprovohet propozim i Kryetarit të Komunës, me Nr.II-156 t, i dt.30.07.2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësimin e paluajtshmërive të pronave të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat do të preken nga projekti për ndërtimin e sheshit të qytetit në Obiliq, sipas listës së pronave të përshkruara nga evidenca kadastrale për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik po ashtu dhe sipërfaqet e tyre të cilat tabela paraqesin pjesët përbërse të këtij Vendimi.
- II. Vlera e kompenzimit për pronën që do të shpronësohet do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit për përlogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që do të shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
- III. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 do të zhvilloj procedurat e shpronësimit.

- IV. Për zbatimin e tij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, Drejtoria e Financave .
- V. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

KUVENDI I KOMUNËS SË OBILIQIT

01-Nr. 108

Më datë. 31-07-2018

Kryesuesi i Kuvendit

Burim Gërguri

